



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:045146
Datë: 24.05.2024
Numri i dokumentit: 05730706

Ac.nr.3296/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Nora Bllaca-Dula, kryetare e kolegjit, Halide Reka dhe Ylber Shurdhiqi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses V.H nga fshati Zh....., Komuna e G....., të cilën e përfaqëson i autorizuari M.N, avokat nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit — Drejtoria Komunale për Arsim, të cilën e përfaqëson B.M, për shkak të pagesës së shpenzimeve të ushqimit gjatë punës, shpenzimeve të rrugës dhe shpërblimit jubilar, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.804/2020, të datës 20.01.2022, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 22.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Gjilanit — Drejtoria Komunale për Arsim, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.804/2020, të datës 20.01.2022, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.804/2020, të datës 20.01.2022, ka vendosur si vijon: “ *I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses V.H nga Gj..... dhe OBLIGOHET e paditura Komuna e Gjilanit — Drejtoria Komunale për Arsim në Gjilan, që paditëses t'i paguaj shumën totale të hollave prej 1936,52€ dhe atë: në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit gjatë punës për periudhën prej dt. 18.04.2017 deri më dt. 22.01.2021, për 592 ditë pune të pranisë në punë, nga 2,00€ në ditë shumën prej 1184,00 €.*

në emër të kompensimit të shpenzimeve të rrugës për periudhën prej dt. 18.04.2017 deri më dt. 22.01.2021, për 592 ditë me nga 0,70€ në ditë, pra 70% sipas çmimit së biletës së autobusit e Cila ka vlerën 1,00€ shumën prej 331,52€, në emër të kompensimit të shpërblimit jubilar për 30 vite përvojë pune shumën prej 421,00€ (100% nga paga e saj bazë), të gjitha me kamatë ligjore prej 8% nga dita e ushtrimit të padisë më dt.08.04.2020 deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. II. OBLIGOHET e paditura që paditëses t'i kompensoj shpenzimet e procedurës në shumë prej 270,00€, në afat prej 7 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit”.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor, ka paraqitur ankesë e paditura, përmes të autorizuarit të saj, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke propozuar që Gjykata e Apelit e Kosovës ta aprovojë si të bazuar ankesën e të paditurës, të prishë aktgjykimin e shkallës së parë dhe lëndën ta kthejë në rishqyrtim dhe në vendosje ose ta refuzojë në tërësi kërkesëpadinë e paditësit.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur paditësi, përmes të autorizuarit të tij, duke i kundërshtuar pretendimet ankimore të paditurës, me propozim që Gjykata e Apelit ta refuzojë ankesën si të pabazuar dhe aktgjykimin e shkallës së parë ta vërtetojë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, përmes të autorizuarit të tij, me datën 08.04.2020 ka paraqitur padi kundër të paditurës, me objekt kontesti kompensim i shpenzimeve të ushqimit udhëtimit dhe pagës jubilarë, ndërsa me datën 17.01.2022 ka bërë precizimin e kërkesëpadisë në kuptimin objektiv, duke kërkuar që e paditura ta bëjë kompensimin e shujtës t’iu paguajë shumën prej 1184 €, në emër të shpenzimeve të udhëtimit në shumën prej 331.52 € dhe në emër të kompensimit të shpërblimit jubilar në shumën prej 421 €, të gjitha këto të llogaritura me kamatë prej 8% e cila do të llogaritet nga data e përfundimit të ekspertizës të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësit dhe precizimit të saj, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.804/2020 të datës 20.01.2022, me të cilin e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nuk është i kontestueshëm fakti se paditësja është në marrëdhënie pune te e paditura, dhe se në ditën e lëshimit të vërtetimit më dt. 04.12.2021 ka pasur 35 vjet përvojë pune, çka është vërtetuar në

bazë të Kontratës së punës nr. dt..... Malishevë nr...../2020 i dt. dhe nr..... i dt. Sipas vërtetimeve të cekura paditësja në periudhën kohore prej dt. 18.04.2017 deri më dt. 25.02.2020, ka qenë e pranishme në punë te e paditura për 444 ditë pune, ndërsa në periudhën prej dt. 18.04.2017 deri më dt. 22.01.2021 ka qenë e pranishme për 592 ditë pune. Paditësja e shfrytëzon transportin publik për vajtje dhe shkuarje nga puna, e kjo është vërtetuar nga kuponët fiskal dhe se çmimi i biletës në relacionin Zh.....-M.....me transport publik që është 0,50€ një drejtim. Sipas vërtetimit mbi vendbanimin, paditësja vendbanimin e ka në fshatin Zh....., Komuna e Gj....., përderisa nuk është kontestuese se paditësja punon në fshati Ma..... Sipas listës së pagave për muajin nëntor 2019, paditësja ka pagën bazë 421,00€, ka përvojë pune 33 vjet dhe është anëtare e sindikatës. Duke u nisur nga fakti se paditësja në ditën e lëshimit të vërtetimit mbi përvojën e punës nr..... të dt. 25.02.2020 ka pasur përvojë pune 33 vjet, 8 muaj dhe 22 ditë, rezulton përfundimi se jubileun 30 vjeçar të punës e ka pasur në vitin 2017, kurse padinë e ka ushtruar më dt. 08.04.2020, e meqë shpërblimet jubilarë paguhen në 7 mars të çdo viti, del përfundimi se e paditura ka qenë e obliguar që paditëses t'i paguaj kompensimin për 30 vjet pune më së voni deri më dt. 07.03.2018, por këtë nuk e ka bërë. Andaj, e paditura është e obliguar që paditëses t'i paguaj shumën e gjykuar në emër të shpërblimit jubilar për 30 vite punë si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar.

Lidhur me pretendimin për parashkrimin e kërkesës gjykata e shkallës së parë e refuzoi si të pabazuar, sepse paditësi padinë e ka ushtruar me dt. 08.04.2020, pra brenda afatit kohor të paraparë me ligj, respektivisht me nenin 87 të Ligjit të Punës, i cili shprehimisht parasheh se: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda afatit prej tri vitesh nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, andaj rezulton se padia e paditësit është parashtruar brenda afatit ligjor prej 3 viteve, dhe rrjedhimisht kërkesëpadia e paditësit nuk është përfshirë në parashkrim ashtu siç pretendon e paditura.

Lidhur me mënyrën e vendosjes vendimin e bazoi në nenin 35 paragrafi 5, 7 dhe 8 të Kontratës Kolektive Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2022. Për kamatën ka vendosur konform nenit 382 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së dhe vendimi për shpenzimet e procedurës kontestimore është bazuar në nenin 453 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k), n) dhe m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për

themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, se nuk është i kontestueshëm fakti se paditësja është në marrëdhënie pune te e paditura, dhe se në ditën e lëshimit të vërtetimit më dt. 04.12.2021 ka pasur 35 vjet përvojë pune, çka është vërtetuar në bazë të Kontratës së punës nr. Malishevë nr. i dt. 25.02.2020 dhe nr. 105/2021 i dt. 04.12.2021. Sipas vërtetimeve të cekura paditësja në periudhën kohore prej dt. 18.04.2017 deri më dt. 25.02.2020, ka qenë e pranishme në punë te e paditura për 444 ditë pune, ndërsa në periudhën prej dt. 18.04.2017 deri më dt. 22.01.2021 ka qenë e pranishme për 592 ditë pune. Paditësja e shfrytëzon transportin publik për vajtje dhe shkuarje nga puna, e kjo është vërtetuar nga kuponët fiskal dhe se çmimi i biletës në relacionin Zh....-M..... me transport publik që është 0,50€ një drejtim. Sipas vërtetimit mbi vendbanimin, paditësja vendbanimin e ka në fshatin Zh....., Komuna e Gji....., përderisa nuk është kontestuese se paditësja punon në fshati M..... Sipas listës së pagave për muajin nëntor 2019, paditësja ka pagën bazë 421,00€, ka përvojë pune 33 vjet dhe është anëtare e sindikatës. Duke u nisur nga fakti se paditësja në ditën e lëshimit të vërtetimit mbi përvojën e punës nr. 45/2020 të dt. 25.02.2020 ka pasur përvojë pune 33 vjet, 8 muaj dhe 22 ditë, rezulton përfundimi se jubileun 30 vjeçar të punës e ka pasur në vitin 2017, kurse padinë e ka ushtruar më dt. 08.04.2020, e meqë shpërblimet jubilarë paguhen në 7 mars të çdo viti, del përfundimi se e paditura ka qenë e obliguar që paditëses t'i paguaj kompensimin për 30 vjet pune më së voni deri më dt. 07.03.2018, por këtë nuk e ka bërë, andaj pretendimet ankimore u refuzuan të pathemelta.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes si në aktgjykimin e ankimuar, në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale për arsye se:

Me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”*. Me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: a) nivel të vendit, b) nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes”*. Me paragrafin 3 të këtij neni, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës”*. Me paragrafin 5 përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive...”*.

Me nenin 35 paragrafin 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2022 përcaktohet se: *“Të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”*. Në paragrafin 5 të kësaj Kontrate përcaktohet se: *“Punonjësit të kësaj Kontrate përcaktohet se arsimor që*

udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70 % të biletave të trafikut urban”. Me nenin 35 paragrafi 8 pika 3, të KKAK parashihet se: “Punëtorët në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, për 30 vjet përvojës së punës në vlerë prej 100% të një page bazë”, ndërsa, sipas pikës 5 të të njëjtit paragraf: “Shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi kur i punësuar ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kriterëve përkatëse”. Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, duke vendosur decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, me të drejtë është bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2022, të lidhur dhe nënshkruar nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK-ut) dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës (MASHT), e cila kontratë ka qenë në fuqi me rastin e lindjes së të drejtës për parashtrim të kërkesës për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit për ditët në punë, shpenzimeve të udhëtimit dhe pagës jubilarë, që nënkupton se kjo Kontratë shërben si akt nga i cili buron themelësia e kërkesëpadisë së paditësit.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se në këtë rast ekziston detyrimi juridiko - civil, i të paditurës ndaj paditësit për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit – shujtës gjatë ditëve të pranisë në punë, pagës jubilarë dhe për shpenzime të udhëtimit, për arsye se me nenin 245 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”.

Gjykata e Apelit, mori parasysh pretendimin ankimor të të paditurës lidhur me faktin se Kontrata Kolektive e Arsimit nuk është obligative për të paditurën, për arsye se nuk janë përmbushur kushtet e parapara me nenin 46 të kësaj Kontrate, meqenëse nënshkruerit e kësaj kontrate siç janë MASHT-i, SBASHK-u dhe Ministria e Financave nuk janë angazhuar asnjëherë për zbatimin e dispozitave që janë implikime financiare. Lidhur me këto pretendime, Gjykata e Apelit vlerëson se referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, rrjedh se obligimi për përmbushjen e të drejtave të të punësuarve të parapara me këtë Kontratë, përfshirë të drejtën për kompensim ushqimit, për ditët e pranisë në punë, shpenzimeve të udhëtimit dhe shpërblimi jubilar i takon pikërisht punëdhënësit, që në rastin konkret i bie të jetë e paditura. Në këtë pikëpamje, çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e kësaj Kontrate, nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditësit, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet e pa themeltë, ndërsa në nenin 2 par.1.2 të Kontratës Kolektive e Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, ndër të tjera thuhet se: “Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat - DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës...”, ndaj detyrimi për zbatimin e kësaj kontrate ka fuqinë ligjore, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet e pathemeltë.

Kjo Gjykatë pati parasysh edhe pretendimet lidhur me parashkrimin e kërkesës, por vlerëson se as ky pretendim nuk qëndron pasi që paditësi kërkesën e saj e ka parashtruar brenda periudhës kohore 3 vjeçare të përcaktuar me Ligjin e Punës, më konkretisht me nenin 87 ku përcaktohet se: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. ndërsa dispozitat e LMD-së siç ka pretenduar e paditura se janë kërkesa mujore nuk mund të zbatohen në rastin konkret, sepse kemi të bëjmë me kërkesa nga marrëdhënia e punës e të cilat kërkesa janë të rregulluara me Ligjin e Punës, i cili zbatohet në kontestet e kësaj natyre, andaj vjen në shprehje afati 3 vjeçar i parashkrimit, e i cili në rastin konkret nuk ka arritur sepse paditësi e ka parashtruar kërkesën e tij brenda afatit të përcaktuar me ligj.

Vendimi mbi kamatën është në përputhje me dispozitën e nenit 382 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së, ndërsa vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitën nga neni 453 të LPK-së pasi që veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese janë arsyetuar drejtë, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lart cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragrafi 1, pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.3296/2022, me datë 22.05.2024

Kryetare e kolegjit,
Nora Bllaca-Dula, d.v.